

INTEGRIMI NË ISLAM

Falënderimet e sinçërta me zemër e shpirtë me mendje e gjuhë ia bëjmë Allahut që të gjitha i ka kriju. Me islamin na dalloj e gradoj vetëm Atij i lutem i mëshitetem dhe prej Atij ndihmë kërkoj. Ka thënë Allahu i lartësuarë në kur'an: *"O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët. E nëse devijoni pasi që u kanë ardhur argumentet e qarta, ta dini pra se All-llahu është i plotfuqishëm, i vetëdijshëm."*

Përshendetjet me salatu ve selam ua dërgojmë të gjithë te dërguarve të Allahut dhe vules së tyre Muhamedit a.s. Paqa dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. I cili është mësuesi dhe zotri i gjithë njerëzimit dhe na ka këshilluar e mësuar kur ka thënë: *"Muslimani i cili shoqërohet me popullin, duron dhe vuan kur e shqetësojnë është më i mirë se ai i cili nuk shoqërohet me ta dhe të cilin nuk e shqetësojnë"*

Allahu i madhë me krijoi shqiptarë
Jamë musliman e qëndrojë krenarë
Vijë nga populli i lashtë ilir
E kamë islamin fenë më te mirë

Muslimanë jamë krenarë e i lumtur
Muslimanë do të jemë i palëkundur
Muslimanë do të jemë kudo e gjithmonë
Islami është krenarija jonë

Të nderuar vëllezër e motra!

Ateizmin-Pa besimi, është sindrom, dobësi virus sëmundje dhe nënçminim i njeriut që në botën bashkëkohore kan mbetur edhe ashtu të hutuar te vetmuar dhe pak pasohen nga njerëzit elhamdulillah. Nëse ndonjë dijetarë ka folur jo mirë për islamin apo kur'anin ai mundë të jetë i pa informuar për islam mundë të jetë i nxitur nga dikush kundër islamit apo edhe nga fanatizmi e gjelozija që nuk e lejojnë ta thotë të vertetën. Apo mbi të gjitha ende nuk e ka pirë ujin e pastër në burim nuk e ka shijuar kur'anin direktë.

Islami imponon shkencën e dijen diturinë nga vetë fakti se islami nuk trashëgohet por mësohet dh ebesohet nga kur'ani dhe suneti.

- Ateizmi tek populli ynë por edhe tek njerëzit në përgjithësi është i përhapur tek gjenerata e mesme, sepse koha e edukimit të tyre ishte ateizmi. Tek ata që janë të prishur moralishtë dhe që njohin fare pak gjëra nga shkenca. Ata janë të dhënur pas iluzioneve që nuk kanë të bëjnë me dijen shkencën dhe dijetarët. Siç na sqaron Kur'ani ku thuhet:

وَمِنَ النَّاسِ مَن يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ مُّنبِئٍ ثَانِيٍ عَظِيمٍ لِيُضِلَّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ لَهُ فِي الدُّنْيَا خِزْيٌ وَنَذِيقُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَذَابَ الْحَرِيقِ

E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së All-llahut, duke mos pasur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm. Ai që shtrembëron qafën (në shenjë mendjemadhësie), e përpiket t'i humbë njerëzit nga rruga e All-llahut. Atij do t'i takojë poshtërimi në këtë jetë, ndërsa në ditën e kijametit atij do t'ia veshim dënimin e djegies (të zjarrit).

Nëse këta të rinjë apo të mesëm sjellin argumentin se shkenca e dija janë rrugët e ateizmit bota bashkëkohore sjellë me mijëra argumente se dijetarët po i kthehen islamit po integrohen në islam. Pra ka shumë argumente se dijetarët e kanë gjetur Krijuesin kurse ju keni mbetur në huti.

Kam lexuar shumë raste të konvertimit në islam,që nga koha e Muhamedit .a.s e deri në ditët e sotme.Gjithashtu kamë përjetuar në mënyrë indirekte hyrjen në islam të nje Suedezi, kurse në qytetet e Kosovës shpesh dëgjojmë kovertimin të islam të personaliteteve të ndryshme.

Pastaj edhe kamë pasë rastin të takohem me disa vëllëzër e motra që kanë hyrë në islam. Nga Sirija nuk mundë ta harroi Aliun nga Britania, Mejremin nga Spanja, Ebu Bekrin nga Amerika, Sadikun nga Franca. Kurse ne Norvegji kisha shumë emocione kur lexova artikullin ne gazeten e përditshme AFTENPOSTEN "FRA GUD TIL ALLAH"- " Prej Zotit tek Allahu" Ku shkruan 800 të rinjë Norvegjez gjatë ramazanit (2006) janë konvertuar në Islam. Ky artikull ishte hapi i parë që në hytbe të flasë Norvegjishtë ne një Xhami shqiptare ne qytetin Halden ku në xhuma kishte edhe tjerë nacionalitete arab, afganistanas, pakistanez dhe turq....

Një arikull tjetër "HIJAB BLITT MOTTE", "Hixhabi do të bëhet modë" ishte material i madhë për mua dhe bashkëshorten time të flasim për Hixhabin. Ku sqarohet se Një spital në Oslo prej uniformave të motrave medicionale ka edhe hixhabin, pastaj Kompania Ikea për punëtoret që duan ta praktikojnë shaminë, ka ofruar uniformen me hixhab.

Kamë takuar edhe disa nga Norvegjezët që kanë hyrë në islam si edhe disa nga ata që interesohen të dijnë më shumë për Islamin, numri i të cilëve kalon numrin 3 shifrorë.

Një shkrimtarë i yni me rastin e ardhjes në përendim thërret për integrim e jo asimilim.

Me rastin e ardhjes në xhami ndër të tjera thotë:

Mësova rrugën e drejtë të integritit
Të ecë me botën përmes besimit
Të jemë largë vetive të shkatërrimit
Mësova qëllimin e krijimit

Allahu i lartë e bëri njeriun nyje në të cilen lidhet bota kështu qe me rasti e fillimit të krijimit të tij u njoftoi engjullve.

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً

(Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!"Një misionar timin në Tokë.

Detyra e njeriut është ta falenderoi adhuroi e mbi të gjitha ta njohë krijuesin e vërtetë sepse vetëm njeriu e ka këtë mundësi Ta njohë Allahun pasiqe për të nënshtrou të gjitha në qiejë dhe tokë.

Nga ana tjetër nuk ka mirësi në tokë për njerëzimin as qetësi e as progres begati shpëtim e pastërti si edhe harmoni me ligjet natyrore pa kthim te Allahu xh.sh. Ky kthim nuk është ashtu që njeriu të kthehet kur ti bije ndërmend apo objekt i zgjedhjes dua apo s'dua por imperative,urdhër.

قُلْ لَا يَسْتَوِي الْخَبِيثُ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْخَبِيثِ فَاتَّقُوا اللَّهَ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

Thuaj: "Nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira, po edhe nëse të mahnit ty shumimi i së keqes, pra kini frikë All-llahun (e mos pranoni të keqen) o ju të zotët e mendjes, ashtu që të shpëtoni"

Praktikimi i islamit nga ne është shembulli më i mirë nga ana tjetër nuk duhet të frigësohemi nga hija e jon sepse po të deklaroheni musliman në fabrikën apo firmen ku punoni askush nuk u nënçmon përkundrazi u rrespektojnë 64 % e norvegjezve pajtojn jetesën me musliman por normal askush nuk e don njeriun që vetëm quhet mysliiman. Siq e themi ne shpesh emrin Hasan e veprat Stojan.

Kurse për përhapje duhet filluar nga vetvehtja familja jon por nuk duhet lënë mangut as rrethin ku jetojm duke zgjedhur vendin ,kohën por edhe individët.Bile ata vetë interesohen për fenë tonë.Ne duam te integrohemi në evrop a evropa është duke u integruar në islam.Pasi ta shtjellojmë temën ton do t'u sjellim argumente për këtë.

- Muhamedi a.s në fillimt ë shpalljes së tij zgjodhi disa njerëzi që duhej t'i thërriste në islam,me të drejtit me të dijshmit me të devotshmit jo familjarër.A thua a do të na zgjedhte neve?

Pra vraponi ne vepra të mira dhe që ta meritojmë të jemi të zgjedhur nga dikush. Ty te duan njerëzit aq sa ti i don ata sillen mirë me ty aq sa ti sillesh mirë me ta. Të respektojnë aq sa i respekton ti.

Por shfrytëzoje rastin të tregohesh i mirë. Ta shfrytëzojmë rastin për të bër vepra të mira dhe për tu radhitur në radhët e besimtarëve. Mos të ngurrojmë e mos të na vije marre që vetveten tonë ta prezantojmë besimtarë të Allahut xh.sh.. Ideologjitë dhe ideali kanë dallime ideologjitë e njeriut jetojnë një kohe dhe së bashku me themeluesit përfundojnë në të shumtën në gropën e urrejtjes. Mësimi i Allahut feja e Allahu asnjëherë nuk ka ndryshuar as nuk ndryshon. Por bëhu besimtarë.

Bile ndoshta një ditë kthehemi por bëhet vonë.

Njeriu harxhon e financon shumë në jetën e tij të cilën do ta leje një ditë.

Për financimin e parë Allahu ka krijuar njeriun ka dërguar 124 mijë pejgamber ka shpallur 4 libra të shenjta e me mijëra fletushka vetëm me një qëllim që njeriu të jetë i udhëzuar.

Detyrë e jona kryesore është që ta njohim të vërtetën ta dallojmë të vërtetën nga jo e vërteta e pasi ta dimë rrugën e drejtë duhet që ta praktikojmë në jetën tonë të përditshme.

Detyra e tretë është që t'ia mësojmë këtë të vërtetë dikujt duke filluar që nga fëmijët dhe familjet tona.

Pa dyshim se shenjat më të mira orientuese në rrugën e praktikimit dhe përhapjes së islamit i gjemë në fjalën e Ati që e ka shpallur dhe e ka urdhëruar këtë fe për ne. Pra duhet të bazohemi në kur'anin fjalën e Allahut xh.sh dhe hadithin fjalën e resulullahit s.a.v.s.

Këtë na sinjalizon Allahu në kur'anin e tij se kur'ani udhëzon në atë që është e vërtetë por gjithashtu edhe na sqaron se ata besimtarë e besimtare që bëjnë vepra të mira i pret shpërblimi i madhe.

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّذِي هِيَ أَفْوَمٌ وَيُنَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ إِنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا

„Është e vërtet se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh“.

Financimi për edukimin e fëmijëve tanë pikë se pari por edhe të rrethit ku jetojmë kërkon sakrificë durim e mençuri që fatkeqësisht të tjerët i praktikojnë a ne i kemi mësimet herët për këto. Muhamedi a.s hapin e parë për ti ftuar familjen në islam bëri një darkë 45 veta aty lajmërohet virusi i asaj familje Ebu lehebi “Per këtë punën që ia ke nisë mos, se ke me i ba armiq krejt arabët na humbet tregtia. Muhamedi a.s nuk polemizoi. Nuk e la huq nuk e quajti te dështuar nuk u ndal me kaq. Pas një kohe i thirri prapë në një darkë dhe i klasifikoi pak 30 veta. Foli i pari, falënderoi Allahun dhe u solli argumentin se: Nuk ju gënjej juve...

Pra edhe ne duhet të investojmë në fëmijët t'ua mësojmë kur'anin kjo është ngritje e brezit tonë të rijë është ecje paralel me të rinjtë evropian. *Kurani famëlartë, është në listën e librave më të shitura dhe të lexuara tek të rinjtë evropian.* Në këto ditë të fundvitit raportohet se në shumicën e vendeve jo myslimane libri famëlartë i kuranit blihet si një dhuratë për krishtlindje. Sipas raporteve të ndryshme nga vendet evropiane vërehet se qytetarët evropianë po dëgjojnë çdo ditë gjëra të reja në lidhje me islamin dhe për këtë arsye ata dëshirojnë të thellojnë njohuritë dhe diapazonin e tyre në lidhje me këtë fe hyjnore. Revista Gjermane FOCUS njoftoi se shitja e Kur'anit Famëlartë në Danimarkë është shumëfishuar dhe me këtë Kur'ani ka arritur të hyjë në listën e dhjetë librave më të shitura. Pas karikaturave nënçmuese ndaj Profetit Muhammed a.s. që një gazetë Daneze i kishte publikuar, një teolog kishte marrë përsipër përkthimin e Kur'anit në gjuhën Daneze e cila tani edhe gjendet në treg. Kështu që gjatë festës së Kërshëndellave, Kur'ani ishte regjistruar si libri i dytë më i shitur në këtë vend.

Pastaj, Ahmeti nga Brazili e memorizoi Kuranin Famëlartë në moshën 13 vjeçare, emërohet si hafëzi i parë në Amerikën Latine, nga Brazili. Ai është i pari prej myslimanëve të Amerikës Latine që e ka mësuar Kur'anin përmendësh. Qëllimi më i madh i Ahmetid është t'i studioj shkencat Islame në njërin prej shteteve myslimane. E këtë qëllim i ndihmon shteti i tij. Edhe dikush nga fëmijët tanë nëse donë ta studioji Islamin jam i sigurt se shteti do ta financoi. Integrohu rini shqiptare në mërgim qëllimin të bëhet aventurist duhet hjekur nuk duhet shkuar pas këtyre hapave por duhet integruar në atë që bota po integrohet.

Me 1972 është ngritur xhamia e parë shqiptare ne Amerik. Në përrurimin e kësaj xhamie merr pjesë edhe presidenti i atij shteti nga SHBA-të i cili ndër të tjera patë thënë: E dua popullin shqiptarë sepse që dy vjet që e udhëheqë këtë shtet asnjë shqiptarë nuk është në burg”. Kështu na të përkrah bota e Norvegjia, si duket botës bashkëkohore nuk i intereson përkatësia fetare apo edhe i konvenon gjithë botës së njerëzitet të jenë të udhëzuar në rrugën e drejtë në mënyrë që në vend të burgjeve të financohet ne çerdhe fëmijësh apo vende tjera pushimi e argëtimi.

Të jesh mysliman i dorëzuar në ligjin e Allahut xh.sh. do të thotë të jesh përballë dy sfidave aktuale asaj për ruajtje nga asimilim si dhe asaj të integritimit në shoqëritë ku jemi. Dikush nga myslimanët mendon se për ta ruajtur fenë kulturën dhe traditën e tij duhet të jetë i mbyllur dhe mos të dalë jashtë mos të shoqërohet me të tjerë (e dikush as më mysliman) por kështu nuk urdhëron islami apo praktika jetësore e njeriut bashkëkohorë ka treguar rezultat vetëm asimilimin, andaj duhet dalë shoqëruar dhe mbajtur e prezantuar islamin me dinjitet e krenari.

Ai që del shoqërohet, punon, shkollohet është mysliman më i mirë por detyrë është që të jetë mysliman i plotësuar, praktikant mos të rrejë mos të shpifë mos të bajë fjalë mos t'ju beson fjalëve të huaja ta ruaj nderin, pastërtinë, lëvizjen, trupin e vet e edhe shikimin dhe mendimin e keq. Këtë nuk po e them unë e ka thënë mësuesi i gjithë njerëzimit Muhamed mustafaja salallahu alejhi ve selem. I cili ka thënë: "Myslimani i cili shoqërohet me popullin, duron dhe vuan kur e shqetësojnë është më i mirë se ai i cili nuk shoqërohet me ta dhe të cilin nuk e shqetësojnë"

Ka pasur nga të dërguarit e Allahut xh.sh. që populli i mundonte shumë por ata prapë bisedonin me ta i luteshin Allahut për ta. Si thuhet në një hadithë:

Muhamedi a.s ka thënë: Sikur e shikoj njerin nga pejgamberet e Allahut të cilin e persekutojnë, e mundojnë, e torturojnë, e kanë rrahur aq fortë sa që i del gjaku. Ai e fshinë gjakun me dorën e tij dhe bërtet e lutet O Allah fali këta njerëz sepse ata nuk janë që e dinë çka po bëjnë" Neve askush nuk na rrah deri me sot pse jemi mysliman.

Myslimanet janë të obliguar ta vazhdojnë rrugën e tyre të besimit dhe praktikimit të islamit edhe nëse kanë pengesa e në këtë kohë në këtë vend nuk kemi kurfar pengese.

Pengesa e parë është kënda po na kënda me jetuar pa rregull e pa planë, po na kanda me pas shumë krona (valuta norvegjeze) pa e shikua a është hallall a haram.

Edukimi hyjnorë, edukimi i Allahu është që ne ta kemi cakun dhe pikësynimin kryesore vetëm fitimin e kënaqësisë së Allahut vetëm praktikimin e fjalëve të tij dhe të dërguarit të Tij e shpërblimi është i saktë pa kurfar dyshim se do të vijë nga Ai në dorën e të cilit është gjithçka.

Muhamedi a.s një ditë i tha Aliut r.a „Nëse nga fjala jote dikush udhëzohet vlenë më shumë se sa kodra e madhe e Uhudit të jetë me ari,“

Një dijetarë i quajtur Shibli ka thënë: "Unë kam marrë mësim nga 400 mësues ka mësua 4 mijë hadithe sherif prej tyre nga këto hadithe sherif kam zgjedhur një dhe kam jetuar sipas tij. Po te ky hadithë kam gjetur të gjitha këshilla të nevojshme. Hadithi sherif që kam zgjedhur është ky : "Puno për këtë botë aq sa do të jetosh në këtë botë. Bindu Allahut aq shumë sa ke nevojë për të. Vepro gjynahe vetëm aq sa mundë ta arrish të durosh xhehenemin"

Një herë ishte sëmur i nderuari Shibli. Sulltani i asaj kohe i cili e merre vesh këtë gjë i dërgon një doktor të pa fe. Doktorin ia afrua shtratit ku qëndronte i shtrirë Shibli dhe e pyeti. Çfarë të dëshiron shpirti. Ai ia ktheu: Shpirti im dëshiron që ti të bëhesh mysliman. Doktorin tha: Në qoftë se unë bëhem mysliman ti me të vërtetë a shërohesh dhe ngritësh nga shtrati?

Shibli tha: Pa tjetër që shërohem menjëherë dhe ngrihem nga shtrati. Kur doktorin u nderua duke u bërë mysliman, nga sëmundja e Shiblilit nuk mbeti më asnjë shenjë. U kapën të dy dorë për dorë dhe shkuan te sulltani. Sulltani kur i pa këta të dy tha: "Unë mendoja se kisha qar doktorin tek i sëmuri por në të vërtetë paskam qar të sëmurin tek doktorin."

Kemi shumë shembuj lidhur me këtë se pot ë jemi të integruar në islam kushtet janë shumë të përshtatshme tek ne (Norvegji) ku në aeroport u hap xhamia për ata që duan të falen në spital pastaj në bazën e tranvajve e autobusëve kjo është bërë haptazi ishte në televizion e gazetë. Edhe për bajram u dhanë pushim atyre që ishin agjërues si nxënësve e studentëve ashtu edhe punëtorëve, vetëm disave

jo sepse gazda i kishte parë se ata gënjejnë nuk agjëronin dhe kur kërkuan pushim u tha jo. Ju nuk e meritoni festën e agjërit (bajramit) sepse nuk keni agjëruar si myslimanët e tjerë. Kështu do tu thotë edhe Allahu në Ahiret. Ju nuk e meritoni xhenetin se nuk keni punuar për të”.

Pra praktikimi i islamit nga ne është pasqyrë për vetveten por edhe për të tjerët. Ne një rast Muhamedi a.s u afrua tek dera e Qabesë dhe filloi të falet pas tij fëmija i vogël Aliu pas tij gruaja e tij Hatixheja. Eashi i pa dhe po e pyet Abasin çka po bëjnë kështu. Abasi i tha po i luten Allahut .Ai është djali i vëllait tim edhe ai i vogli djali i vëllait tjetër kurse kjo mbrapa tyre është gruaja e tij. Muhamedi po thotë se më vije shpallje prej Allahut. A po donë të të njoftoj me Muhamedin. Ai tha lemë ta bëjë tregtinë. Dhe vazhduan. Pas 20 viteve kur Muhamedi a.s hyri me ushtrinë e tij në Mekë si triumfues vije prapë Eashi dhe pranon islamin por qante shumë. Muhamedi a.s i thotë „Mos qajë, se hyrja në islam ti falë të gjitha mëkatet. Esh-athi tha po qajë qe nuk e kamë bërë më herët. Vonë tash nuk kam jetuar si mysliman më herët.

Subhanallah çfarë thirrje duhet ta bëjmë tani, thirrje që Allahu i madhe ua bëri besimtarëve: Hyni në islam. O mysliman hyni në islam tërësisht...

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السَّلَامِ كَافَّةً وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ
فَإِنْ زَلَلْتُمْ مِّنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْكُمُ الْبَيِّنَاتُ فَاَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishtëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaji i hapët. E nëse devijoni pasi që u kanë ardhur argumentet e qarta, ta dini pra se All-llahu është i plotfuqishëm, i vetëdijshëm”.

Ajeti i dytë është ai që na futë në temën tonë: Nëse devijoni pasi që keni qenë të privilegjuar me ajetet e qarta nga Kur’ani dijeni se Allahut nuk i bëni dëm aspak Allahu këtë din e zgjeron edhe me njerëz tjerë. Si edhe ky ajet:

وَيَسْتَبْدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ وَلَا تَضُرُّوهُ شَيْئًا وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“ju zëvendëson me një popull tjetër dhe Atij nuk i bëhet farë dëmi. All-llahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë.”

Nga ana tjetër jemi duke e parë me sytë tanë integrimin e vendeve tjera në Islam e sa për ilustrim sjellim disa shembuj: Dhoma e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan zyrtarisht filloi punimet ku pas zgjedhjeve të zhvilluara më 7 nëntor të këtij viti ndër kandidatët fitues ishte edhe Keith Ellison, i cili e kishte pranuar islamin gjatë studimeve universitare. Për herë të parë në historinë e SHBA-ve. Për betim zyrtarë e tradicionalë e shfrytëzoi një Kuran nga biblioteka e presidentit të tretë të këtij shteti dhe një nga themeluesit e SHBA ve Thomas Jeffersonit. Autoritetet qeveritare në qytetin e Atlantës-Nju Xhersi, vendosën që festat tradicionale islame, përkatësisht Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami, të njihen si ditë pushimi zyrtar në institucionet e arsimit publik. Agjencia e lajmeve “United Pers International”, sqaroi se ky ligj do të hyjë në fuqi duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor.

Ndërkohë Austria renditet ndër të parat vende evropiane që ka njohur zyrtarisht Islamin, dhe ku shteti, lejon zhvillimin e lëndës së kulturës islame si pjesë e programit mësimor në arsimin publik

Sipas artikullit në The Nev York Sun është duke u pritur aprovimi i qeverisë Angleze për konstruktimin e xhamisë më të madhe të Evropës e cila do të ketë kapacitetin e pranimit të 60 mijë besimtarëve. Afër Stadiumit olimpiq 2012. Pikë takim që nuk është parë deri më sot (nga udhëheqësit e projektit, 152 mil euro harxhim). Vendi, qyteti i ndërtimit vend ku fliten 100 gjuhë edhe shqipja, Nju Ham

"LONDON MERKEZI" qendra e Londrës në Britani. Sipas regjistrimit 2001, 24% e popullatës së këtij qyteti janë mysliman. Kur jemi të Anglië potencojmë edhe këtë se: Sipas gazetës Sunday, me burim nga Ministria e Brendshme Angleze, në ushtri do të punësohet një teolog të fesë islame. Gjithashtu ushtria angleze ka rezervuar vendin e nevojshëm për kryerjen e riteve fetare të ushtarëve të saj myslimanë, si dhe u siguron atyre ushqimet që u lejon feja, i lejon ata të agjërojnë muajin e shenjtë të Ramazanit ...

Një gjimnaz në Milano të Italisë, vendosi të hapë një klasë të veçantë për nxënësit myslimanë. Nxënëset myslimane do të marrin pjesë në mësim me shaminë e kokës dhe mësimin e ushtrimit fizik do ta zhvillojnë në një orë të veçantë nga nxënësit e tjerë. Një vendim tjetër është për një pushim zyrtar në shkollat ku gjenden nxënës myslimanë gjatë festave të Bajramit të Ramazanit dhe atij të Kurbanit.

Greqia e ka njohur Islamin shumë herët, qysh nga gjysma e parë e shekullit të parë të hixhretit të Muhammedit, Alejhi selam. Më konkretisht, Greqia e njohu Islamin në vitin 210 sipas hixhretit, kur nën komandën e Ebu Hafs Umer El Endelusijj. Në Greqi gjenden përafërsisht 300 xhamia monumentale, shumica e të cilave në zonën Ebro. Qeveria greke ua ka lejuar myslimanëve meremetimin e shumë xhamive kohëve të fundit. Në qytetin Komotene, janë riparuar 14 sosh. Në ujdhesën Rodos janë riparuar 5 sosh ndërsa në ujdhesat e tjera, si në ato përreth Detit Aigaion janë disa të tjera në riparim e sipër. Kurse në Athinë do të ndërtohet xhamia këtë vit, 2007.

Prej 1976 është bërë kërkesë për ndërtimin e një xhamie në kryeqytetin e vetëm të shtetit anëtarë në BE. Parlamenti miratoi projektin për ndërtimin e xhamisë në Athinë që ka 300 mijë mysliman dhe Greqia ishte deri tani shteti i vetëm në BE që nuk ka xhami në kryeqytet.

Në Gjermani ekzistojnë mase 2300 xhamia dhe qendra Islame. Në Gjermani nga 82 milionë banor, mbi 3 milion mysliman. 3 Tetori, dita e bashkimit të Gjermanisë, dallon me një manifestim nga myslimanët, vizitojnë xhamitë XHAMIA E HAPUR.

Në Gjermani jetojnë afro 3 milion pjesëtarë të besimit islam, prej tyre numrin më të madh e përbëjnë të ardhurit nga Turqia. Dukshëm vërehet ndryshimi i strukturës të atyre që kalojnë në islam. Përdërisa vite më parë numri më i madh i konvertuesve kishte të bëjë me gjermanet të cilat martoheshin me partnerët e besimit mysliman. Në kohën e fundit vërehet një numër mjaft i madh i atyre që në fenë islame kalojnë për shkak të bindjeve të tyre. Arsye për kthimet e shumta drejt islamit, sipas mendimit të sociologes Maonika Eohrab Sahr, është nevoja për ndryshim. "Mes qershorit të vitit 2004 dhe atij 2005. Rreth 4.000 gjerman janë konvertuar në Islam, çka do të thotë katër herë më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm", qëndron në raportin i cili nuk është publikuar deri më sot që sipas kërkesës së qeverisë federative e ka hartuar arkivi islamik. Sot, në tërë Gjermaninë numërohen mbi 141 xhami (me minare).

- Lev Nikolovitch Tolstoi (1828-1910) - shkrimtar dhe mendimtar i mprehtë, dha një kontribut madhor në letërsinë dhe historinë ruse. Në moshën e pleqërisë ishte i vetmuar sepse e donte islamin. Në një nga letrat e tija gjendet kërkesa e tij "Kërkoj të më konsideroni mysliman "Nga popullata 144 milionëshe, sa numron Rusia afro 20 milion janë Mysliman. Islami është më i përhapur në rajonet e Kaukazit. Gjatë luftës ndaj Çeçenisë, mediumet Ruse krahasonin Islamin me terrorizëm. Megjithatë numri i Myslimanëve është në ngritje të sipër.

Populli belg është 10 milion, prej të cilëve 450.000 janë mysliman artikulli në gazetën belge "Lose ëar", Briseli është qytet me përqindjen më të madhe të popullatës e cila vitet e fundit janë konvertuar në islam, në krahasim me qytetet tjera evropiane. Vitet e fundit mbi 40. 000 belgë konvertohen., shkaku kryesor i animit kah feja islame është se në islam mes Zotit dhe njeriut nuk ka ndërmjetësues, dhe pastërtia e jetës morale gjë për të cilën vuan bota perëndimore dhe evropiane.

Mbi 5 mijë danez janë bërë mysliman tre viteve të fundit. Kurse një grua myslimane kandidohet në zgjedhjet parlamentare në Danimarkë do të vazhdojë të mbajë mbulesën islame.

Spanja është e njohur me islamin e para prej vendeve evropiane. Në Kataloni jetojnë 800.000 mysliman nga gjithsejtë 1.5 milion mysliman sa janë në Spanjë. Ata të përbërë nga spanjoll si edhe nacionalitete tjera kanë marrë fushate për ndërtimin e një xhamie të ngjashme me atë të Madridit. Numri i xhamive në Kataloni arrin numrin 169 –çka do të thotë 10 herë më shumë se në vitin e kaluar. Por e rrugës është që ne të jemi shembulli më i mirë që dikush të bëhet myslimanë duke na pare neve, ne jemi pasqyrë e islamit të tjerët na shikojnë neve dhe mendojnë kështu qenka islami. Prandaj duhet ta kemi shumë në hatër se islami është amanet nga Allahu që na ka krijuar.

Allahu na mundësoftë mbajtjen me krenari të këtij dini si dhe përhapjen e tij në rrethet ku jetojmë .Allahu na mundësoftë integrimin e tërësishëm në islam.